



Duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.5 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, si dhe në Ligjin Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 03/2011/KRPP

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të ofrojë interpretimin zyrtar të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, pasi që këto dy dispozita janë kontradiktore.

Neni 2 Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik.

Neni 3 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

3.1 Neni 13.1 i LPP-se kërkon që të gjitha dokumentet që lidhen me kontratat me vlerë minimale, të ulët, të mesëm dhe me vlerë të madhe duhet të përgatiten në gjuhën shqipe dhe serbe, kurse gjuha angleze nuk është e detyrueshme, pasi që autoritetet kontraktuese ", mund të përgatisin edhe ... në gjuhën angleze. "

3.2 Neni 13.2 i LPP-se megjithatë kërkon dokumente "... që çojnë në dhënien e kontratave me vlerë të madhe ... në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. "

3.3 Kjo kontradiktë do të thotë se duhet vendosur nëse versioni në gjuhën angleze i dokumenteve përkatëse duhet të përgatiten edhe në anglisht.

Neni 4 Interpretimi i nenit 3

4.1 Në mënyrë që të forcohet konkurrenca për kontratat publike kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese që të përgatisin të gjitha dokumentet relevante gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit për dhënien e një kontrate apo konkursi të projektimit me vlerë të madhe në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Neni 5

Përgjegjësia e autoriteteve kontraktuese

Zyrtari i prokurimit dhe personat tjerë të autoritetit kontraktues që kanë marrë pjesë në përpilimin e dokumenteve për prokurimin publik, obligohen për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Dt. 15.03.2011
Prishtinë,


Safet Hoxha - Kryetar i KRPP